| **Buletini Nr. 69/ 2023, 10-03-2023** | **Parashikimi** nga 10-03-2023, ora 12:00 deri më 11-03-2023, ora 23:59. |
|---|---|

## PARASHIKIMI I RREZIKUT NGA PËRMBYTJET

----------------------------------------------------

Gjatë ditës së sotme (e premte, dt.10) do të ketë reshje me intensitet të lartë, të cilat do të jenë më të përqëndruara në veri dhe në pjesën qendrore të vendit. Në qarqet Shkodër, Kukës dhe Lezhë mund të ketë vërshime të shpejta të lumenjve të vegjël malorë dhe rrëshqitje të dherave. Në zonat urbane në qarqet e përmendura më sipër si dhe në qarqet Durrës, Tiranë dhe Elbasan mund të shfaqen probleme me përmbytje të lokalizuara, në varësi të gjendjes së kanalizimeve.

## PARASHIKIMI METEO

--------------------------

### RESHJET

Sot pasdite (e premte, dt.10) priten reshje intensive në qarqet Shkodër, Kukës, Lezhë, Durrës, Tiranë, ndërsa në qarqet Dibër, Elbasan, Vlorë dhe Gjirokastër priten reshje mesatare deri lokalisht intensive. Në qarqet e tjerë priten reshje të dobëta deri lokalisht mesatare (siç tregohet në tabelë, respektivisht për secilin qark). Reshjet në shumicën e qarqeve do të shoqërohen me shtrëngata. Nesër e (e shtunë, dt.11) priten reshje të dobëta në të gjitha qarqet.

### TEMPERATURAT

Nesër (e shtunë, dt.11) temperaturat minimale dhe maksimale të ajrit pritet të arrijnë:

në bregdet: 11 / 17 °C

në vendet e ulëta: 10 / 16 °C

në vendet malore: 5 / 11 °C

### ERA

Sot pasdite (e premte, dt.10) era pritet të fryjë e lehtë deri mesatare, ndërsa në bregdet deri e fortë. Nesër (e shtunë, dt.11) era pritet të fryjë e lehtë deri mesatare.

| ***NIVELET E RREZIKUT*** | **S'KA RREZIK** | **I ULËT** | **I MODERUAR** | **I LARTË** |
|---|---|---|---|---|

## *PARASHIKIMI I DETAJUAR MBI RREZIQET NATYRORE (SOT DHE NESËR)*

| ***RREZIKU MAKSIMAL I QARKUT*** | ***Zjarre në pyje*** | ***Ngjarje Meteorologjike*** | | | ***Ngjarje Hidrologjike*** | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | ***Zjarret Mesatarja e qarkut*** | ***Reshje 24-orëshe Mesatarja e qarkut*** | ***Reshje 24-orëshe Maksimale të lokalizuara*** | ***Shtrëngata*** | ***Përmbytje të Shpejta*** | ***Përmbytje Lumenjsh*** | ***Rrëshqitje toke*** |
| **SHKODËR** | S'KA RREZIK | intensive | |  |  | |  |
| **KUKËS** | S'KA RREZIK | intensive | |  |  | |  |
| **DIBËR** | S'KA RREZIK | mesatare | intensive |  | | | |
| **LEZHË** | S'KA RREZIK | intensive | |  |  | |  |
| **DURRËS** | S'KA RREZIK | intensive | |  | | | |
| **TIRANË** | S'KA RREZIK | intensive | |  | | | |
| **ELBASAN** | S'KA RREZIK | mesatare | intensive |  | | | |
| **FIER** | S'KA RREZIK | të dobëta | mesatare | | | | |
| **BERAT** | S'KA RREZIK | të dobëta | mesatare | | | | |
| **KORÇË** | S'KA RREZIK | të dobëta | mesatare | | | | |
| **VLORË** | S'KA RREZIK | mesatare | intensive |  | | | |
| **GJIROKASTËR** | S'KA RREZIK | mesatare | intensive |  | | | |

| | |
|---|---|
| **Buletini Nr. 69/ 2023, 10-03-2023** | **Parashikimi** nga 10-03-2023, ora 12:00 deri më 11-03-2023, ora 23:59. |

## LEGJENDA: *Reshjet 24-orëshe*

| **Niveli i Rrezikut** | ***Reshje shiu*** (mm / 24 orë) |
|---|---|
| S'KA RREZIK | të dobëta (0 – 15 mm / 24 orë) Nuk priten fenomene hidro-meteorologjike problematike. |
| I ULËT | mesatare (15 – 45 mm / 24 orë) Mundësi që të shfaqen fenomene hidro-meteorologjike problematike. |
| I MODERUAR | intensive (45 – 90 mm / 24 orë) Moti parashikohet i rrezikshëm. Parashikohen fenomene të pazakonta hidro-meteorologjike. |
| I LARTË | shumë intensive (> 90 mm / 24 orë) Moti është shumë i rrezikshëm. Parashikohen fenomene të pazakonshme hidro-meteorologjike mjaft intensive. |

## LEGJENDA: *Zjarre në pyje*

| | |
|---|---|
| S'KA RREZIK | Zjarret e mundshëm janë të kontrollueshëm lehtësisht. |
| ULËT | Barërat e thatë dhe pyjet mund të digjen lehtë. Flakët janë te mesme në pyje dhe të shpejta në zonat e ekspozuara. |
| I MODERUAR | Ndezja e zjarreve mund të ndodhë lehtë dhe me përhapje të shpejtë. Zjarret mund të jenë shumë të nxehtë, me kurora përhapje të vogla dhe të mesme. |
| I LARTË | Ndezja mund të shkaktohet edhe nga një shkëndijë. Zjarret janë shumë të nxehtë me përhapje shumë të shpejtë të flakëve si rrjedhim kontrolli i tyre është shumë i vështirë. |

## *SIMBOLE*

| | |
|---|---|
|  | Shtrëngata: reshje mbi 20 mm/3orë. Moti mund të krijojë probleme të ndryshme |
|  | Përmbytje urbane ose nga përrenjtë dhe lumenjtë e vegjël |
|  | Përmbytje nga lumenjtë e mesëm dhe të mëdhenj |
|  | Rrëshqitje toke |




***RREZIKU MAKSIMAL I QARKUT për sot dhe nesër, dt. 10-11.***